

20121212995

L I G J

PËR GARANCI TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE TË DETYRIMEVE SIPAS MARREVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN “FURNIZIM ME MJETE TË REJA TERHEQESE DHE TË TERHEQURA NË HM TRANSPORTI SHA – SHKUP“ QË DO TË LIDHET NDERMJET BANKES EVROPIANE PËR RINDERTIM DHE ZHVILLIM DHE HM TRANSPORTI SHA – SHKUP

Neni 1

Republika e Maqedonise e garanton permbushjen e detyrimeve dhe plotesimin e dispozitave të Marreveshjes për hua për Projektin “Furnizim me mjete të reja terheqese dhe të terhequra në HM Transporti SHA – Shkup” që do të lidhet ndermjet Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim dhe HM Transporti SHA – Shkup në shume prej 50 000 000 euro, nese HM Transporti SHA – Shkup nuk i ploteson dhe servison kushtet nga Marreveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe menyra e shfrytezimit të huas nga neni 1 i ketij ligji percaktohen me Marreveshje për hua, që do të lidhet ndermjet Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim dhe HM Transporti SHA – Shkup për Projektin “Furnizim me mjete të reja terheqese dhe të terhequra në HM Transporti SHA – Shkup”.

Neni 3

Të gjitha detyrimet që dalin nga Marreveshja për hua nga neni 1 i ketij ligji, si dhe servisimin e huas do ta kryeje HM Transporti SHA – Shkup nga të hyrat që i realizon, me afate dhe kushte të percaktuara në Marreveshje për hua.

Neni 4

Afati i pageses së huas nga neni 1 i ketij ligji eshte 15 vjet me grejs periodhe të perfshire prej tre vitesh e gjashte muaj.

Shkalla e kamates eshte variabile dhe perbehet prej EURIBOR gjashtemujor i zmadhuar për margjine prej 1%.

HM Transporti SHA –Shkup do t’i paguaje Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim provizion të njehershem në lartesi prej 1% nga shuma e huas.

Për shumen e mjeteve të paterhequra të huas, Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim do t’i paguhet provizion në lartesi prej 0,5% nga shuma e mjeteve të paterhequra të huas në nivel vjetor.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndersjella që dalin nga Marreveshja për hua dhe Marreveshja për garanci, Ministria e Financave dhe HM Transporti SHA – Shkup do të lidhin marreveshje të vecante.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise”.